



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Novobërdës ((KNB)), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Parcelat dhe objektet në 21 zona kadastrale që janë në pronësi të komunës nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe njëherit nuk janë shpalosur në PFV.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Novobërdës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### **Baza për konkluzion**

- A1 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar katër (4) punonjës pa zhvilluar procedura të rekrutimit.
- B2 Komuna ka angazhuar një punonjës për shërbime të veçanta pa udhëhequr paraprakisht procedurat e prokurimit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Novobërdës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Novobërdës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Novobërdës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë,

por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Novobërdës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Novobërdës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e

administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: angazhimi i punonjësve pa procedura të rekrutimit, mos pagesa e obligimeve brenda afatit të paraparë ligjorë, të arkëtueshmet, mos regjistrimi i pasurive në regjistrat kontabël, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe pesë (5) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

##### Gjetja

Sipas nenit 20 të rregullorës nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare përorganizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës. Më tej, potencohet se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ të cilat duhet të regjistrohen në SIMFK.

Komuna nuk ka arritur të regjistrojë 21 zona kadastrale parcelat dhe objektet që janë në pronësi të komunës, nuk kishte emëruar komisionin për vlerësimin e pasurisë, kështu që nuk ka arritur ti vlerësojë dhe regjistrojë 29 veturat e saja, të cilat janë pa vlera, derisa 19 prej tyre janë jashtë funksionit. Çështjet e ngritura, tregojn se vlera pasurive të paraqitura në PFV nuk është e drejtë dhe e saktë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket menaxhimit të pasurisë, si dhe mungesa e vullnetit nga ana e menaxhmentit për ta rregullarë çështjen e pasurive.

##### Ndikimi

Çështjet e ngritura lidhur me regjistrimin, vlerësimin e pasurisë, nuk japin informata të sakta mbi gjendjen dhe shfrytëzimin e pasurisë. Kjo potencialisht mund të ndikojë në keq menaxhimin apo keq përdorimin e pasurisë dhe paraqitje jo të drejtë dhe të saktë në PFV.

##### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të siguroj se pasuria e komunës është vlerësuar dhe se janë të regjistruara të gjitha pasuritë në disponim të komunës. Më tutje, të siguroj që informatat e paraqitura në PFV-të lidhur me pasuritë të jenë të

drejta dhe të sakta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Angazhimi i stafit pa procedura të rekrutimi

**Gjetja** Rregullorja (QRK) Nr.16 / 2020 Për Pranimin në Shërbimin Civil, neni 6, pika 2 përcakton se pranimi në shërbimin civil bëhet me konkurs publik. E njëjta gjë vlen edhe për nëpunësit publik, kështu që në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, neni 8, pika 1 thotë se çdo punëdhënës në sektorin publik është i obliguar të shpallë konkurs publik sa herë që vendos marrëdhënie të re të punës.

Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar katër (4) punonjës pa zhvilluar procedura të rekrutimit. Punonjësit janë angazhuar përmes kontratave të rregullta të punës, tre me afat të caktuar dhe një me afat të pacaktuar, të nënshkruara nga menaxhmenti i komunës.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrolleve nga ana e menaxhmentit, në mënyrë që të ketë një plan të rekrutimeve dhe zbatimit të rregullores përkatëse për rekrutim.

**Ndikimi** Punësimi i punëtorëve të rinjë pa procedura të rekrutimit, mund të ndikojë në përzgjedhjen e kandidatëve jo profesional për kryerjen e detyrave të punës.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj se ka përgatitur planin për rekrutimin e stafit, dhe njëkohësishtë pozitave e lira të punës të plotësohen nëpërmjet procedurave të rregullta të rekrutimit përmes konkursit publik.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedura ligjore.

**Gjetja** Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114 në neni 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Në një rast kemi identifikuar se komuna ka angazhuar një punonjës për shërbime të veçanta, për të cilin, nuk ka pasur thirrje publike dhe nuk është zhvilluar procedura siq kërkohet me ligjin përkatës.

Nuk kemi marrë ndonjë sqarim konkret nga ana e zyrtarëve komunal, pse nuk kanë zbatuar procedurat e përcaktuara për angazhimin e shërbyesve me kontrata për shërbime të veçanta.

**Ndikimi** Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, rritë rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara, e cila mund të reflektoj edhe në

performancën e tyre në punë.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të siguroj se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e punonjësve për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 403,362€, prej tyre ishin shpenzuar 378,386€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të mirëmbajtjes, shpenzime për derivate, lëndë djegëse dhe shpenzime të tjera operacionale.

#### Çështja A2 - Parregullsi në procedimin e pagesave

**Gjetja** Sipas Rregullës financiare nr.01/2013, neni 22, janë përcaktuar procedurat e përgjithshme për pocedimin e pagesave.

Nga (9) mostrat e testuara në vlerë prej 28,774€, kem hasur në tri mostra me vlerë 17,244€, faturat janë pranuar para urdhërblerjes, para raportit të pranimit të mallit dhe para zotimit të mjeteve.

Shkak i kësaj ishte mos komunikimi në mes njësisë kërkuese, zyrtarit për pranimin e faturave dhe zyrtarëve të pranimit të punëve/mallrave, që rezulton në mos funksionim të kontrolleve te brendshme.

**Ndikimi** Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë pranimit të mallit dhe kryerjes së pagesave mund të ndikojë në pranimin e mallrave që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara dhe në pagesa potencialisht të parregullta.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, të nxirret urdhërblerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVF e pasurive kapitale është 2,081,189€, pasurive jokapitale është 0€, si dhe e stoqeve 0€.

#### **Çështja B3 - Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para përgatitjes të PFV-së, si dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria**

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Nenet 18 dhe 19 si dhe paragrafët 4.6 dhe 4.7 përcaktojnë që komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare, përgatit raportin për kryerjen e inventarizimit si dhe hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Si dhe neni 6.3 përcakton se, pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Komisioni për inventarizim nuk e kishte kryer punën si duhet, duke mos kryer inventarizimin e plotë, por vetëm pjesërisht duke mos bërë krahasimin e raporteve të inventarizimit dhe regjistrit të pasurisë.

Po ashtu Komuna nuk kishte regjistruar pasurinë jo kapitale dhe stoqet në sistemin e-pasuria dhe si rezultat i kësaj vlera e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve në PFV është me 0.

Mos kryerja e plotë e inventarizimit të pasurive dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria kishte ndodhur për shkakë të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

**Ndikimi** Mos kryerja e plotë e inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe mos funksionalizimi i sistemit të e-pasurisë reflekton negativisht në saktësinë dhe plotësinë së regjistrave të pasurisë dhe në prezantimin e tyre në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurohet se bëhen krahasim i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Gjithashtu të sigurohet se është duke u respektuar rregullorja për pasuritë financiare dhe jo financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpалosur Llogari të Arkëtueshme (LI.A) në vlerë prej 507,223€. Kjo vlerë përbehet nga LI.A për tatimin në pronë 468,857€ dhe nga qiraja në vlerë 38,366€.

#### Çështja B4 - Dobësi lidhur me menaxhimin (inkasimin) e llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenin 26 të Ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme 06-L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Nga testimi i 14 mostrave në vlerë prej 33,326€, kemi identifikuar se, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.

Sipas komunës, kjo ka ndodhur si pasojë e gjendjes ekonomike dhe sociale dhe që është ndikuar nga mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë.

**Ndikimi** Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuara me ligj ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde të vogla për arritjen e synimeve, dhe inkurajon debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për menxhimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2021, ishte 35,295€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2022.

#### Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave

- Gjetja** Me nenin 39 të LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet, shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.
- Nga testimi i pesë mostrave në vlerë prej 1,331€, kemi vërejtur që në katër raste, faturat në vlerë totale prej 1,110€ nuk janë paguar në afatin ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë prej 30 deri në 90 ditë.
- Sipas komunës, shkak i mos pagesave me kohë ishte mungesa e mjeteve.
- Ndikimi** Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjorë, rritë mundësinë që furnitorët ti drejtohen përmbauesve dhe gjykatave, që rezultojnë me shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.
- Rekomandimi B5** Kryetari duhet të siguroj që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjorë dhe porosia e mallrave, punëve apo shërbimeve, bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht siguron fondet apo ndanë mjete buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>2,808,423</b>	<b>3,252,583</b>	<b>2,901,588</b>	<b>3,022,446</b>	<b>2,717,701</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	2,585,487	2,544,350	2,529,864	2,728,075	2,473,012
Financimi përmes huamarrjes	0	7,013	7,013	23,625	13,003
Të bartura nga viti i kaluar	0	64,751	64,139	54,722	46,355
Të hyrat vetanake	222,936	222,936	199,723	140,628	154,999
Donacionet vendore	0	90,512	75,515	1,340	0
Donacionet e jashtme	0	323,020	25,335	74,056	30,332

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 444,160€. Rritja e buxhetit është rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak në vlerë prej 64,752€, financimit nga huamarrja 7,013€ si dhe grantet e përcaktuara të donatorëve me vlerë 413,532€ (nga BE dhe Qeveria Zvicerane). Ndërsa, kishte zvogëlim me rishikim të buxhetit prej 41,137€.

Komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore. Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomike janë dhënë më poshtë:

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>2,808,423</b>	<b>3,252,583</b>	<b>2,901,588</b>	<b>3,022,446</b>	<b>2,717,701</b>
Pagat dhe mëditjet	2,106,144	2,091,755	2,070,269	2,016,390	1,898,527
Mallrat dhe shërbimet	303,335	333,677	308,801	285,370	257,016
Komunalitë	69,259	69,685	69,585	71,416	65,949
Subvencionet dhe transferet	49,521	185,426	52,840	267,566	22,615
Investimet Kapitale	275,812	567,688	400,093	381,704	473,594

Rezervat	4,352	4,352	0	0	0
----------	-------	-------	---	---	---

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte më i ulët për 14,389€, krahasuar me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim vie me rastin e rishikimit të buxhetit nga granti qeveritar.

-Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 30,342€, nga kjo vlerë, 7,381€ ishin nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe 22,961€ nga donacioni.


-Buxheti final për komunalitet ishte rritur për 426€ nga të hyrat vetanake.

-Buxheti final për subvencione ishte rritur për 135,905€, nga kjo vlerë, 528€ kishte rritje nga të hyrat vetanake, 7,000€ janë pranuar nga qeveria si përkrahje për vërsime edhe 128,377€ nga donacionet.

- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 291,876€. Vlera prej 56,415€ ishte nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe 235,461€ nga donacioni. Donacioni është pranuar në fund të muajit dhjetor të vitit 2021 dhe vetëm 25,335€ e shumës ishte shpenzuar apo 8%. Performanca e realizimit të investimit kapitale është ndikuar edhe nga mjetet e shpenzuara nga donacionet.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 63,622€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 344,312€ dhe kanë pasur një rritje prej 173,065€ në krahasim me vitin 2020, ku të hyrat ishin 171,247€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 62,088€, gjobat e gjykatave 2,860€ dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 9,525€.




**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>222,936</b>	<b>222,936</b>	<b>344,312</b>	<b>171,247</b>	<b>161,321</b>
Të hyrat tatimore	102,934	102,934	84,448	71,449	62,362
Të hyrat jo tatimore	120,002	120,002	259,864	99,798	98,959

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020, ka rezultuar në 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar pesë (5) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha blerjet dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen saktë në regjistrin e pasurive nga zyrtari i pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive. Kryetari duhet të sigurohet se sistemi e-Pasuria përdoret nga zyrtari i pasurisë dhe se aplikohet norma e zhvlerësimit. Të gjitha pasuritë nën 1,000€ duhet të regjistrohen në sistemin e e-pasurisë në mënyrë që të ulët rrezikun e keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.	Komuna nuk ka bërë regjistrimin e plotë të pasurisë, e-pasurisë dhe hamonizim të inventarit.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive të rishikimit nga ana e menaxherit të financave për të konfirmuar se vlerat e prezantuara të llogarive të arkëtueshme në PFV janë të sakta dhe të	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar

		plota. Po ashtu, duhet të sigurojë se ka një bashkëpunim efektiv në mes sektorit të financave dhe atij të tatimit në pronë sa i përket të arkëtueshmeve.		
3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e rekrutimit i respektojnë të gjitha procedurat e kërkuara për të pranuar kandidatët që kanë numrin maksimal të pikëve në testin me shkrim dhe intervistë. Ky proces duhet të jetë konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore sipas UA 07/2017 për shërbyes publik duke pranuar kandidatët meritor.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia të zyrarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që çdo herë kur paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit. Gjithashtu blerja e produkteve të bëhet sipas procedurave adekuate të prokurimit. Në rastet kur financimi është nga donatorët të definohet me marrëveshje të financimit/grantit se çfarë procedura të prokurimit parashikohen të zhvillohen.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që njësitë bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit dhe zyra e prokurimi të forcoj kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se bëhen krahasim i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Gjithashtu të sigurohet se është duke u respektuar rregullorja për pasuritë financiare dhe jo financiare.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për menjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim për mbledhjen e llogarive të arëtueshme nga tatimi në pronë.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara, të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF. Gjithashtu, Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Edhe këtë vit, komuna nuk i ka paguar faturat brenda afatit të parapar ligjor.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Komuna ka marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm




Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Ejup Simnica, Udhëheqës i ekipit



Milos Petrovic, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
Komuna e Novobërdës  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



ZYRA E KRYETARIT / KANCELARIJA GRADONACELNIKA

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,



Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Novobërdës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Sasa Mitosovic,

Data: 10.05.2022,  
Novobërdë,

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**



Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.